



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:232369  
Datë: 30.08.2023  
Numri i dokumentit: 04630761

**C-IV-13-0891**

*Ankuesi*

**J J**

*Përfaqësuar nga av B I, nga I A Prishtinë.*

*Kundër*

*E Paditur*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 30 gusht 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. APROVOHET** ankesa si e bazuar dhe **ndryshohet** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. PRN032-0098, datë 11 qershor 2013.
- 2. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit **J J** në emër të kompensimit për 13 paga të papaguara për periudhën janar 2006 – janar 2007, t’i paguaj **shumën neto prej 3,614.00 €** dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t’i paguaj **shumën prej 361.40 €**.
- 3.** Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- 4. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej **25.00 €**.

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 17 qershor 2023, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një kërkesë/ankesë kundër Vendimit nr. PRN032-0098 i datës 11 qershor 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa për kompensim për paga të papaguara në shumë prej 3,614.00 €, nga NSH “Magjistrala” (në likuidim). Në ankesën e tij, ankuesi pohoi se AKP-ja ka hedhur poshtë kërkesën e tij për kompensim të pagave të papaguara me rastin e privatizimit të NSH “Magjistrala”. Ankuesi më tej pohon se NSH-ja i ka mbetur borgj 13 paga të papaguara dhe se të gjithë dëshmitë apo dokumentet e nevojshme tregojnë se kam punuar në këtë ndërmarrje për periudhën për të cilën kërkoj pagat që nuk më janë paguar. Ankuesi i propozoj gjykatës që të

aprovj ankesën e tij si të bazuar dhe të hedh poshtë vendimin e të paditurës ashtu që gjykata të nxjerr një vendim të ri në favor të tij duke ia njohur të drejtën në kompensim të 13 pagave të papaguara të gjitha këto në shumë prej 3,614.00 €. Në mbështetje të ankesës së tij ankuesi ka dorëzuar dëshmitë në kopje si: vendimin e kundërshtuar të AL-së, librezën e punës, Vendimin për pranim në punë në NSH nr. 601, datë 03 gusht 1990 dhe listën e pagave të NSH Magjistrala NJP Prishtinë për periudhën janar 2006 – maj 2007.

Me 4 shtator 2013, përfaqësuesi i ankuesit nëpërmjet parashtrësës së tij dorëzoi autorizimin për përfaqësim të ankuesit dhe ri-dorëzoi disa dëshmi si librezë e punës dhe lista e pagave të NSH-së në mbështetje të ankesës.

Me 24 tetor 2013, e paditura parashtrroi mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se i përmbahet qëndrimit se ankesa e ankuesit nuk është as e pranueshme (ankesa nuk specifikon se cili nen i ligjit është shkelur) as e bazuar (AL ka zbatuar me të drejtë ligjin për të drejtën materiale dhe ka bërë një vlerësim të saktë të kërkesës dhe dëshmime të disponueshme). E paditura më tej pohoi se ankuesi nuk ka specifikuar se cili nen i Ligjit nr. 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit dhe si rrjedhojë ka shkelur nenin 70.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme, i cili parashih që ankesat e paraqitura në gjykatë kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendim se procesi i likuidimit nuk ka qenë në përputhje me Ligjin (nr.04/L-034) për AKP, andaj ankesa është e papranueshme. E paditura më tej pohoi se ankesa është e pabazuar pasi ankuesi nuk i ka ofruar AL dokumentacionin e plotë në lidhje me kërkesën dhe listat e pagave të dorëzuar nga ankuesi nuk janë autentike. E paditura propozoi që ankesa të hedhet poshtë si e papranueshme ose të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar. Në mbështetje të mbrojtjes së saj e paditura ka bashkëngjitur dëshmitë si: Kërkesa për caktimin dhe përbërjen e AL, dhe disa lista të pagave të njëjësive të NSH-së për periudhën shkurt – maj 2007.

Me 18 mars 2014, përfaqësuesi i ankuesit dorëzoi përgjigjen e tij në mbrojtjen e të paditurës.  
Me 28 prill 2014, e paditura dorëzoi kundërpërgjigjen e saj.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrirat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Neni 14.1 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës) parasheh që: *“Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës”*. Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH “Magjistrala”. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja se a ka ofruar shërbime pune ankuesi dhe a i ka mbetur borgj NSH për periudhën janar 2006 – janar 2007 (13 paga). E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme dhe autentike tek AL siç janë listat e pagave të NSH-së për këtë periudhë, ndërsa ankuesi pretendon se ka qenë në listën e pagave deri në privatizimin e NSH. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në përmbledhjen mujore të rrogave për periudhën janar 2006 – janar 2007 dhe librezën e tij të punës, si dhe në pohimet e parashtruara në ankesë.

Nga librezat e punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte krijuar marrëdhënie pune në NSH “Magjistrala” nga data 14 shtator 1984 deri me 28 shkurt 1990 dhe pastaj prej 14 gusht 1990 deri më 21 tetor 1991. Nga përmbledhjet mujore të rrogave të punëtorëve të NSH “Magjistrala”, vërtetohet fakti se ankuesi kishte pagë mujore neto në lartësi prej 278.00 €, gjithsejtë ankuesi për periudhën janar 2006 – janar 2007, kishte paga në lartësi prej 3,614.00 €.

Duke u nisur nga kjo gjendje, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës dhe përmbledhjen mujore të rrogave për periudhën janar 2006 – janar 2007, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën e lartcekur dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borgj pagat. Gjykata gjen se listat e pagave mujore nuk janë identike me listat e pagave që i ka dorëzuar e paditura në mbrojtjen e saj (në të cilat lista nuk figuron emri i ankuesit për njësinë NSH Magjistrala në Prishtinë), mirëpo meqenëse listat e pagave të dorëzuara nga e paditura i referohen një periudhe tjetër kohore pra shkurt – maj 2007, gjykata i merr si relevante listat e pagave të dorëzuara nga ankuesi për të përcaktuar shumën që i është njohur ankuesit për periudhën janar 2006 – janar 2007.

E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borgj, ashtu siç përshkruhen në listat e pagave të dorëzuara nga ankuesi. E paditura nuk ka mundur që të dëshmojë nëse ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës para periudhës për të cilën është parashtruar kërkesa.

Me rastin e aprovimit të plotë të shumës së kërkuar për 13 pagat e papaguara, të gjitha këto në lartësi prej 3,614.00, gjykata është bazuar në listat e pagave për periudhën janar 2006 – janar 2007, ashtu që ankuesit gjithsejtë i janë njohur pagat e pa paguara në shumën e kërkuar prej 3,614.00 €. Gjukata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi J J, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borgj pagat për periudhën e lartcekur dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjukata e aprovon shumën në lartësi prej 361.40 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e paditura AKP si palë e pasuksesshme, obligohet ti paguaj shpenzimet e procedurës. E paditura është obliguar ti paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 25.00 € për taksë gjyqësore.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli  
Gjyqtar